



13 SHKURT 2015

SISTEM JURIDIK DHE GJYQËSOR I UNIFIKUAR NË KOSOVË?

Aleksandar Rapajić dhe Trim Kabashi

Më 9 shkurt, kryeministrat e Kosovës dhe Serbisë, Isa Mustafa dhe Aleksandar Vučić respektivisht, u takuan në Bruksel në kuadër të procesit të dialogut të Brukselit. Ky takim, që u ndërmjetësua nga Përfaqësuesja e Lartë e Bashkimit Evropian për politikë të jashtme dhe siguri Federica Mogherini, ishte takimi i parë i tillë pas gati dhjetë muajsh ndërprerjeje si rezultat i, ndër të tjera, zgjedhjeve në Kosovë dhe Serbi, si dhe ngërçit politik gati gjashtë-mujor në Kosovë që pasoi pas zgjedhjeve. Ky ishte takimi i parë mes kryeministrit Mustafa dhe kryeministrit Vučić. Takimi rezultoi me marrëveshje të nënshkruar për gjyqësorin, po nuk u dha ndonjë informatë e hollësishme për marrëveshjen, fushështrirjen, apo afatet për implementimin e saj.

Marrëveshja mbi gjykatat vjen pas gjashtëmbëdhjet vitesh të sistemeve paralele gjyqësore, sidomos në veri të Kosovës. Pas luftës së 1999-tës, Serbia mbajti sistemin e vet gjyqësor në funksion në veri të Kosovës dhe në disa vendbanime me shumicë serbe në jug të lumit Ibër, përderisa Kosova themeloi sistemin e vet gjyqësor. Pas shpalljes së pavarësisë më 2008, dhe në veçanti pas trazirave në ndërtesën e gjykatës në Mitrovicë më 17 mars të atij viti, gjykatat e Kosovës suspenduan punën e tyre në komunat veriore dhe Gjykata e Mitrovicës që funksiononte nën jurisdikcionin e Kosovës u zhvendos në ndërtesën e gjykatës në Vushtrri. Në 2009, Serbia transformoi sistemin e vet gjyqësor dhe i mbylli të gjitha gjykatat në jug të lumit Ibër dhe i mbajti në funksion vetëm ato në veri të Kosovës. Ky dualizëm në sistemin juridik dhe gjyqësor ka krijuar shumë paqartësi në qasjen e barabartë, efektive dhe të drejtë në gjyqësi në mesin e qytetarëve të rëndomtë. Në një moment, gjykata të ndryshme përdornin ligje të miratuara nga UNMIK-u, nga Kuvendi i Kosovës dhe nga Serbia.

Marrëveshja e 19 prillit të vitit 2013 “Marrëveshja e Parë e Parimeve që Rregullojnë Normalizimin e Marrëdhënieve” e nënshkruar mes kryeministrit Hashim Thaçi dhe kryeministrit Ivica Dačić, më në fund trajtoi dualizmin e sistemeve gjyqësore të Kosovës dhe Serbisë në veri të Kosovës. Palët ranë dakord që Gjykata e Apelit në Prishtinë do të krijonte një panel—të përbërë nga një shumicë gjyqtarësh serb të Kosovës—e cila do të i mbulonte të gjitha komunat me shumicë serbe në Kosovë. Një divizion i Gjykatës së Apelit, duke përfshirë stafin administrativ dhe gjykatësit, do ta kishte selinë në Mitrovicën e Veriut.¹ Kjo marrëveshje më në fund duhet të bëjë integrimin dhe unifikimin e sistemit gjyqësor në Kosovë, si dhe të zbusë mosbesimin e komunitetit serb në Kosovë ndaj gjyqësisë si rezultat i mungesës së gjykatësëve dhe prokurorëve që shërbëjnë në atë sistem.

Zbatimi i marrëveshjes, megjithatë, ka ngecur. Plani i zbatimit ka parashikuar formimin e një grupi punues i ngarkuar me zhvillimin e planeve të detajuara për integrimin e autoriteteve gjyqësore serbe në strukturat e Kosovës dhe krijimin e ndonjë strukture të re të kërkuar në bazë të marrëveshjes, përfshirë edhe gjykatat themelore dhe zyrat e prokurorive publike në komunat me shumicë serbe.

¹ <http://www.kryeministri-ks.net/?page=2,191> ose <http://www.srbija.gov.rs/kosovo-metohija/index.php?id=82315>

Nga mesi i qershorit të vitit 2013, Serbia duhet të japë informacion për numrin e personelit gjyqësor që kanë interes të i bashkohen strukturave të Kosovës dhe Kosova duhet të vë në dispozicion pozicionet e kërkuara në strukturat e saj gjyqësore. Përbërja e gjyqësorit duhet të reflektojë përbërjen etnike të juridiksionit territorial të secilit gjykatës. Deri në fund të vitit 2013, të gjitha objektet apo ambientet e punës së gjykatave serbe në Kosovë duhet të ishin mbyllur, organet e reja duhet të ishin ngritur dhe personeli serb duhet të ishte integruar brenda sistemit të Kosovës, pa krijuar boshllëk në ofrimin e shërbimeve gjyqësore. Për shkak të mungesës së një marrëveshjeje për zbatim, gjykatat nën sistemin serb, megjithatë, kanë vazhduar të punojnë në të gjitha rastet, përveç rasteve penale, ndërsa gjykatësit e EULEX-it kanë filluar të punojnë në gjykatën e Mitrovicës në rastet penale. Ky boshllëk në sistem ka krijuar hapësirë për aktivitete të paligjshme dhe rritje të pasigurisë në mesin e popullatës në lidhje me sigurinë personale dhe të pronës.²

Në këtë drejtim, marrëveshja e fundit mbi gjyqësorin ishte më shumë se në kohën e duhur. Kryeministri Mustafa, në fjalimin e tij drejtuar deputetëve të Kuvendit të Kosovës më 12 shkurt, ka deklaruar se marrëveshja do të rezultojë në një sistem të unifikuar të drejtësisë në të gjithë territorin e Kosovës, dhe se gjykatat paralele të cilat kanë operuar deri tani do të mbyllen. Kryeministri serb Vuçiq, në anën tjetër, vuri në dukje se Serbia ka negociuar marrëveshjen më të mirë të mundshme duke përfshirë sa më shumë gjyqtarë serb që është e mundur për pjesën veriore të Kosovës. Ashtu si me çdo marrëveshje ndërmjet Kosovës dhe Serbisë, megjithatë, ekziston një mungesë e dukshme e transparencës mbi atë se për çfarë kanë rënë dakord palët dhe se në të vërtetë detajet mund të zbardhin kuptime kundërtëse. Sipas rrjedhjeve të publikuara në mediet në Kosovë dhe Serbi³, marrëveshja parasheh se do të ketë një Gjykatë Themelore dhe një Zyrë e Prokurorisë për rajonin e Mitrovicës. Ky rajon përfshin komunat e Mitrovicës së Jugut, Mitrovicës së Veriut, Skenderajt, Vushtrrisë, Zubin Potokut, Zveçanit dhe Leposaviqit, dhe ka aktualisht katër degë ekzistuese në Gjykatën Themelore të Mitrovicës (në Leposaviq, Skenderaj, Vushtrri, dhe Zubin Potok). Marrëveshja gjithashtu parashikon se "korniza ligjore e Kosovës do të zbatohet për institucionet gjyqësore në përputhje me Marrëveshjen e Parë" dhe se Kryetari i Gjykatës Themelore të Mitrovicës do të jetë një serb i Kosovës "nga veriu i Kosovës", ndërsa Kryeprokurori i Zyrës së Prokurorisë Themelore do të jetë një shqiptar i Kosovës.

ECMI Kosova mirëpret marrëveshjen si një masë e vonuar për të përmirësuar qasjen në drejtësi për qytetarët e Kosovës që jetojnë në veri të Kosovës. Ekziston një mungesë e detajeve se si dhe çfarë saktësisht përmban marrëveshja, megjithatë, perspektiva e një sistemi uniform të drejtësisë është një hap i madh përpara, kjo do të thotë se vendimet e saj janë ligjrisht detyruese dhe të zbatueshme në të gjithë Kosovën, dhe jo vetëm në pjesën veriore të Kosovës dhe komuna të caktuara. Kjo do të rrisë besimin e publikut në institucionet e Kosovës, dhe gjithashtu do të dërgojë sinjal për investitorët e mundshëm për këtë pjesë të Kosovës të cilët kanë përmendur mungesën e qasjes në mjetet juridike gjyqësore si një nga barrierat kryesore të hyrjes në treg. Ndërsa marrëveshja, nga natyra e saj, do të jetë e hapur për interpretim, bazat e saj nuk janë: një sistem funksional ligjor dhe gjyqësor është gjëja më e rëndësishme për sundimin e ligjit dhe sigurisë për të gjithë dhe në veçanti për qytetarët në veri të Kosovës. Për zbatimin e kësaj marrëveshjeje bazë që këtë herë të jetë e suksesshme, do të jenë të nevojshme transparenca dhe dialogu politik, jo vetëm në Bruksel, por edhe brenda Kosovës.

Për më shumë informacion ju lutem na kontaktoni në + 381 (0) 38 224 473, apo përmes e-mail-it: info@ecmikosovo.org

² "Monotoni e qytetëruar? Mbikëqyrja Qytetare e Implementimit të Marrëveshjes Kosovë - Serbi.", fq. 37, nëntor 2014.

³ <http://www.gazetaexpress.com/lajme/ja-marreveshja-mustafa-vuqiq-per-drejtessin-79818/> ose http://www.b92.net/info/vesti/index.php?yyyy=2015&mm=02&dd=10&nav_category=640&nav_id=956521

Raporte dhe analiza të tjera politike:

- [Çfarë duhet të mbahet mend nga rasti Jablanović?](#)
Shkurt 8, 2015
<http://goo.gl/64uXJC>
- [Thirrje për Arsye dhe Veprim pas protestave në Prishtinë](#)
Janar 25, 2015
<http://goo.gl/yqEvaQ>
- [Farkimi i një ambienti të punës në kuadër të Qeverisë së Kosovës](#)
Janar 19, 2015
<http://goo.gl/fqTYG5>
- [ECMI Kosova dënon bllokadën e dhunshme të hyrjes në Kishën Ortodokse Serbe në Gjakovë](#)
ECMI
Janar 7, 2015
<http://goo.gl/RQZ5A1>
- [Përmbledhje politike: Formimi i Qeverisë së re të Kosovës, Përfaqësimi i komuniteteve pakicë dhe Sfidat që dalin përpara](#)
Dhjetor 10, 2014
<http://goo.gl/ztDfOI>
- [Buletin Informativ i ECMI Kosovës – Një vështrim mbi situatën e fundit të sigurisë në Kosovë](#)
Nëntor 4, 2014
<http://goo.gl/3RyIIc>
- [Përmbledhje e shkurtër e ECMI Kosovës mbi Zhvillimet Politike në vend: Komunitetet pakicë dëshirojnë të shohin fundin e ngërçit politik](#)
Tetor 23, 2014
<http://goo.gl/sBf53x>
- [Partitë politike të minoriteteve në mjedisin politik në ndryshim e sipër në Kosovë](#)
Korrik 31, 2014
<http://goo.gl/sSc7dn>
- [ECMI Kosova bën thirrje për qetësi pas përshkallëzimit të tensioneve etnike pas ndeshjes kualifikuese në futboll midis kombëtareve të Serbisë dhe Shqipërisë](#)
Tetor 15, 2014
<http://goo.gl/88dOMR>
- [Komunikatë për shtyp - Ndërlidhja e ndarjes: Krijimi i një Bordi të Përbashkët për qytetin e Mitrovicës](#)
Qershor 27, 2014
<http://goo.gl/d6XKws>
- [Zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë: Një Shikim i Çështjeve, sfidave dhe skenës politike në prag të zgjedhjeve të 8 qershorit](#)
Qershor 2, 2014
<http://goo.gl/qlrHmd>

INFORMATION BULLETIN

Rreth ECMI Kosovës

ECMI Kosova është organizata kryesore joqeveritare e angazhuar me çështje të komuniteteve minoritare në Kosovë, me qëllim të zhvillimit të institucioneve përfshirëse, përfaqësuese dhe të ndjeshme ndaj komuniteteve, institucione këto që mbështesin një Kosovë të qëndrueshme shumë-etnike. ECMI Kosova kontribuon në zhvillimin, forcimin dhe zbatimin e legjislacionit përkatës, dhe përkrah institucionalizimin e mekanizmave qeveritarë të ndërlidhur me çështje të komuniteteve, dhe ngrit kapacitetet e akterëve të shoqërisë civile dhe të qeverisë për t'u angazhuar me njëri-tjetrin dhe bashkëvepruar në mënyrë konstruktive dhe të qëndrueshme.